



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2077/4 prot.

Datë 29.08.2023

V E N D I M
Nr. 834/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-77508-08-15-2023, me objekt “*Blerje Kancelari*”, me fond limit: 1.431.213,18 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Mbyllje e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Interlogistic” SHPK
Autostrada Tiranë – Durrës, Rruga Dytësore, Km.9, Godinë
3 katëshe, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
Bashkia Tiranë
Rruga “Barrikadave”, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.08.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-77508-08-15-2023, me objekt “*Blerje Kancelari*”, me fond limit: 1.431.213,18 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “*Interlogistic*” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2023/3377, datë 22.08.2023 dhe me Nr. 2077/2023 prot., datë 22.08.2023 për procedurën e prokurimit sipërcituar duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 28.08.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, autoriteti kontraktor ka paraqitur dokumentin “*Ekstrakt i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave*”, datë 25.08.2023, ku konstatohet se ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “*Interlogistic*” SHPK dhe e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë vijon: “*Në lidhje me pretendimin e OE se “Sa më sipër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve teknike për artikullin nr.1 “Dosje me llastik” si dhe artikullin nr.2 “Dosje Arive me Lidhëse” na detyron që të kërkojmë nga autoriteti kontraktor që për këtë artikull të vendoset marzhi i përmasave të artikujve të kërkuar.”, sqarojmë se autoriteti ynë kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike për artikujt dosje (me llastik, arkive dhe me mekanizëm), i është referuar llojeve dhe tipeve të dosjeve që aktualisht gjenden në treg, parametrave standarde të grup-dosjevem si dhe duke patur parasysh natyrën e punës për të cilën ato duhet të përdoren, arkivimin e tyre, kapacitetet mbajtëse të dokumentave, ka përzgjedhur përmasat standarde si në specifikimet teknike. Për të eliminuar problemet e mundshme të prodhuesve të këtyre artikujve në lidhje me përmasat standarde të tyre AK do të ndryshojë dokumentat e tenderit konkretisht specifikimet teknike për artikujt dosje me llastik, dosje arkive me lidhëse dhe dosje me mekanizëm, dhe do të përcaktojë marzhin e mundshëm të ndryshimit ± 3 %, të secilës përmase. Për sa më sipër pretendimi i OE qëndron.”*

II.5. Gjithashtu, në datën 29.08.2023, nëpërmjet shkresës me nr. 1025/9 prot., datë 28.08.2023, protokolluar me tonën nr.2077/3 prot., datë 29.08.2023 me objekt “*Dërgim informacioni, mbi ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” shpk, në lidhje me dokumentat e tenderit, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me objekt “Blerje kancelari*”,

autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP informacion në lidhje me procedurën e prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së ankimuesit “Interlogistic” SHPK, ku konstatohet se ka trajtuar ankesën dhe është shprehur me vendim duke pranuar pjesërisht atë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit *“Sa më sipër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve teknike për artikullin nr.1 “Dosje me llastik” si dhe artikullin nr.2 “Dosje Arive me Lidhëse” na detyron që të kërkojmë nga autoriteti kontraktor që për këtë artikull të vendoset marzhi i përmasave të artikujve të kërkuar.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 28.08.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, autoriteti kontraktor ka paraqitur dokumentin “Ekstrakt i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, datë 25.08.2023, ku konstatohet se ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK dhe e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë vijon: *“Në lidhje me pretendimin e OE se “Sa më sipër, përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve teknike për artikullin nr.1 “Dosje me llastik” si dhe artikullin nr.2 “Dosje Arive me Lidhëse” na detyron që të kërkojmë nga autoriteti kontraktor që për këtë artikull të vendoset marzhi i përmasave të artikujve të kërkuar.”, sqarojmë se autoriteti ynë kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike për artikujt dosje (me llastik, arkive dhe me mekanizëm), i është referuar llojeve dhe tipeve të dosjeve që aktualisht gjenden në treg, parametrave standarde të grup-dosjevem si dhe duke patur parasysh natyrën e punës për të cilën ato duhet të përdoren, arkivimin e tyre, kapacitetet mbajtëse të dokumentave, ka përzgjedhur përmasat standarde si në specifikimet teknike. Për të eliminuar problemet e mundshme të prodhuesve të këtyre artikujve në lidhje me përmasat standarde të tyre AK do të ndryshojë dokumentat e tenderit konkretisht specifikimet teknike për artikujt dosje me llastik, dosje arkive me lidhëse dhe dosje me mekanizëm, dhe do të përcaktojë marzhin e mundshëm të ndryshimit ± 3 %, të secilës përmase. Për sa më sipër pretendimi i OE qëndron.”*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2*

dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK.

Komisioni do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK në lidhje me specifikimet teknike “Në shtojcën 5 është kërkuar nga ana juaj (cituat artikujt nga 1 deri 52) [...] Këto specifikime teknike në lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur, pasi specifikimet teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standardin e lartë për këtë produkt. Ndër të tjera konstatojmë se specifikimet teknike të artikujve të sipërpërmendur, të përcaktuara nga ana e AK janë kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojnë të drejtën e operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.[...]”, gjykojmë se,

III.2.1. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, se kërkesat e autoritetit kontraktor nuk janë të logjikshme, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kërkesat e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për këto specifikime në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar shkeljen e konstatuar qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të paqarta dhe konfuze.

Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” ShPK, se: “[...] *Për artikullin nr.8 “Letër A4” si dhe artikullin nr.9 “Letër A3” në lidhje me specifikimin teknik “Letra të jetë jo më pak se 100 % bardhësi, 100 % puple druri” kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës të ndryshoni që për të dy artikujt e lartpërmendur të ndryshoni specifikimin 100 % bardhësi duke vendosur marzh pasi prodhues të ndryshëm të letrës vendosin marzh në lidhje me këtë specifikim duke krijuar kushtet e paraqitjes pranë autoritetit kontraktor të llojeve të*

ndryshme të letrës gjithnjë cilësore. Ndërsa për specifikimin teknik “100 % pulpe druri” kërkojmë heqjen e tij pasi kjo nuk është në dorë të tregtarëve që ta përmendin në skedat e tyre por politikë e prodhuesve. Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, gjykojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e autoritetit kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcituara në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” ka përcaktuar, ndër të tjera, specifikimet për artikullin letër A4 dhe letër A3, si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

8	Leter A4	Cilesore 80 gr e bardhe (pako 500 flete). Letra te jete jo më pak se 100% bardhesi, 100% puple druri. Të jetë e ambalazhuar me ambalazh fabrike ku të jenë të përcaktuara marka tregtare, numri i fletëve në paketim, pesha specifike e letrës. Në ambalazhin e produktit duhet të jetë përcaktuar 100% pulpe druri ose te vertetohet me certifikate cilesise nga kompania prodhuese.
---	----------	---

9	Leter A3	Cilesore 80 gr e bardhe (pako 500 flete). Letra te jete jo më pak se 100% bardhesi, 100% puple druri. Të jetë e ambalazhuar me ambalazh fabrike ku të jenë të përcaktuara marka tregëtare, numri i fletëve në paketim, pesha specifike e letrës. Në ambalazhin e produktit duhet të jetë përcaktuar 100% pulpe druri ose te vertetohet me certifikate cilesise nga kompania prodhuese.
---	----------	--

III.3.2. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenit 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specififikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specififikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohet për një punë, shërbim ose furnizim”* Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të

ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe, kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.3.4. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Sa më sipër, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknike kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë dhe me diapazon të gjerë duke përdorur një minimum dhe një maksimum të parametrave, në mënyrë që të rritet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të provohet se mallrat objekt-prokurimi, përmbushin kushtet funksionale.

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në mënyrë elektronike në SPE nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se në procesverbalin përkatës për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor nuk ka bërë asnjë argumentim lidhur me specifikimet teknike “100% bardhësi, 100% puple druri” për artikujt letër A4 dhe Letër A3, çka është në kundërshtim me përcaktimet në pikën 2 të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, ku përcaktohet se: *“Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti*

përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

III.3.6. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë këto specifikime teknike të letrës A4 dhe A3 në funksionalitetin e saj dhe çfarë pasojash sjellin në përdorimin e këtij artikulli këto specifikime. Gjithashtu, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë argument dhe nuk ka justifikuar, se në cilat standarde është mbështetur në hartimin e specifikimeve teknike për këto artikuj.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt-prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustificuara shkaktojnë kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar, ndaj autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në lidhje me bardhësinë e letrës A4 dhe A3, duke e hapur diapazonin e parametrave të kërkuar, si dhe të heqë kërkesën për 100% puple druri, si një kërkesë joproporcionale me objektin e prokurimit, e cila kufizon pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë të cilët ofrojnë artikujt objekt-prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-77508-08-15-2023, me objekt “Blerje Kancelari”, me fond limit: 1.431.213,18 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes "Interlogistic" SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

